



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1049\_10\_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 18.11.2013.

**në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin E. B., (shifra e konsumatorit DPR - 14335) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1049\_10\_13 i datës 23.10.2013.

**Arsyetim**

Konsumatori me datë 13.03.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturat për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë. Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 21.03.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 14335, ku kanë evidentuar që nuk mund të bëhet inspektimi i pikës matëse pasi nuk kanë qasje.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 02.04.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në listat e leximit për periudhën janar, shkurt dhe mars 2013.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 23.10.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që faturat e energjisë elektrike të konsumatorit me shifër DPR – 14335 duhet të korrigjohen në vlerë **(-89.89€)**, duke bërë shpërndarjen e kilovatëve (kW) nga periudha 06/2012 deri më 07/2013.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 18.11.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se korrigjimi prej 55.48€ është bërë sipas procesverbalit nr. 024839627 të datës 27.08.2013 dhe se nuk pajtohet me korrigjimin e DMK të ZRRE-së.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se për periudhën kontestuese qershor 2012 e deri më shkurt 2013 konsumatori nuk ka lexim të saktë të shpenzimeve të energjisë elektrike. Pra, sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike aktive dhe faturave të energjisë elektrike vërehet se nga fillimi deri në periudhën 05/2012 ka lexim të saktë në dy tarifën, tarifën e lartë dhe të ulët, ndërsa nga periudha 06/2012 deri më 07/2013 (përveç periudhave: 07/2012, 11/2012, 01/2013), konsumatori është faturuar vetëm në tarifën e lartë.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se korrigjimi është bërë sipas procesverbalit nr. 024839627 të datë 27.08.2013, duhet theksuar se faturimi i energjisë elektrike për konsumatorin me shifër DPR - 14335 nuk është bërë sipas shpenzimeve reale mujore ashtu siç parashihet me nenin 23 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si dhe procedurës për lexim dhe faturim të konsumatorëve tarifor. Andaj për shkak të mos përputhjes së kilovatëve kW të regjistruar në listat e leximit dhe rrjedhës së energjisë elektrike konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi i faturave nga periudha 06/2012 deri më 07/2013 në vlerë **(-89.89€)**.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1049\_10\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar